



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 47/1 Prot.

Tiranë, më 10. 01. 2018

V E N D I M

Nr. 5, Datë 10. 01. 2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 131, datë 03.10.2017, e A. SH., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “*përkatësisë në një grup të veçantë*”¹ dhe “*çdo shkak tjetër*”², nga ana e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se, ILDKPKI në nëntor të vitit 2014 dhe në 13 Janar 2015, ka publikuar emrin e tij në faqen e web-it³, me pretendimin e mosdeklarimit të pasurisë, pas largimit nga pozicioni i punës si Këshilltar i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës. Në këto kushte, ILDKPKI, i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kallëzimin penal nr. 439, të vitit 2015, nëpërmjet të cilit ka paditur ankuesin lidhur me veprën penale “*Rrefuzim për deklarim*”. Në përfundim të procedurave hetimore Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “*Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal Nr. 439 të vitit 2015*”. Sipas ankuesit, ILDKPKI në kundërshtim me ligjin vazhdon të mbajë në faqen e internetit emrin dhe të dhënat e tij personale, që i çenojnë rëndë figurën dhe vështirësojnë angazhimin e tij social apo në sektorin e punësimit. Edhe pse nga ana e ankuesit është kërkuar fshirja e të dhënave nga faqja e internetit nga ana e ILDKPKI-së nuk

¹ Pjesëmarrje në qeverinë e Partisë Demokratike, si nëpunës i lartë i qendrës së djathtë.

² Hakmarrje politike për pjesëmarrje në qeverinë e qendrës së djathtë.

³ <http://www.hidaa.gov.al/13-janar-2015/>

është marrë asnjë masë për këtë. Në vijim ankuesi sqaron se, ILDKPKI gjatë viteve 2013-2015, ka publikuar emrat e 362 personave për gjoba dhe 187 kallëzime penale, ndërsa në vitin 2016 e në vazhdim ky institucion nuk ka publikuar më asnjë të dhënë lidhur me personat ndaj të cilëve janë vënë gjoba apo janë kallëzuar penalisht.

Në këto kushte, ankuesi pretendon se nga ana e ILDKPKI-së janë vendosur praktika diskriminuese lidhur me publikimin e të dhënave personale të zyrtarëve të lartë të shtetit apo ish-personave të ekspozuar politikisht, ku dhe ai bën pjesë.

Në përfundim të ankesës, A. SH. kërkon nga Komisioneri të merren masa administrative për ndëshkimin e personave përgjegjës që synojnë të cënojnë figurat publike për qëllime politike apo korruptive, në rast se dëshmohet një veprimtari e tillë, si dhe fshirjen e emrit të tij nga prezenca on-line e ILDKPKI-së.

Përsa më lart, ankuesi i është drejtuar me ankesë edhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku ka kërkuar: *“fshirjen nga faqja e internetit të të dhënave personale, të cilat nuk janë të rregullta, të vërteta ose të plota dhe cënojnë rëndë figurën e tij në publik, vështirësojnë angazhimin e tij social apo në sektorin publik”*. Pas analizimit të provave, më datë 17.07.2017, nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është vlerësuar se nuk ka shkelje të parimeve ligjore të përpunimit të të dhënave të sanksionuara në nenin 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ishte e nevojshme që KMD të dispononte informacion, fakte dhe prova konkrete, që lidhnin trajtimin e pabarabartë dhe disfavorizues, në krahasim me persona të tjerë, në kushte të njëjta apo të ngjashme, me shkakun e pretenduar nga ankuesi. Në këto kushte, Komisioneri iu drejtua ankuesit me anë të shkresës nr. 956/1 prot., datë 20.10.2017, ku për efekt të shqyrtimit të ankesës së depozituar nga ana e tij, i kërkohej kopje e vendimeve të marra nga ana e Prokurorisë së Rrathit Gjyqësor Tiranë dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, ankuesi me anë të email-it datë 23.10.2017, të dërguar pranë KMD-së vuri në dispozicion informacionin e kërkuar.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në formularin e ankesës nr. 131, datë 03.10.2017, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, A. SH. është vënë në dijeni për sjelljet diskriminuese të pretenduara nga ana e ILDKPKI-së, nëpërmjet publikimit në faqen e web-it të të dhënave të tij, që në vitin 2015. Për këtë fakt, siç ka parashtruar edhe në ankesë, A. SH. është vënë në dijeni më datë 13.01.2015, pavarësisht se këto të dhëna vijnë të qëndrojnë on-line. Pra, momenti në të cilin ankuesi është vënë në dijeni për diskriminimin e pretenduar përkon me datën 13.01.2015. Në këto kushte, mbështetur në informacionin e vënë në dispozicion nga ankuesi, konstatohet se ai ka më shumë se një vit që ka marrë dijeni mbi situatën diskriminuese të pretenduar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “**Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt**”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e saj nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “*Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale*”, 2: “*Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale*”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje*”, ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE:

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/dh e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së A. SH., për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Rekomandimin e subjektit ankues që pretendimin për diskriminim, ta ndjekë gjyqësisht, në zbatim të nenit 36, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)